



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo / Republic of Kosovo**  
**Kuvendi i Komunës Rahovec**  
*Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec*



**PROCESVERBAL**

Mbledhja e rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa, e mbajtur më **21.07.2021**, me fillim në ora **10.00**.  
Mbledhjen e kryesoi kryesuesi i Kuvendit **Afrim Dina**.

**Kryesuesi** – Fillimisht më lejoni të përshëndes, te nderuar anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa, drejtorët e drejtorive, përfaqësues të mediave dhe të gjithë ju të pranishëm.

Të nderuar anëtarë të KPF-së, për këtë mbledhje propozoj këtë :

**REND DITE**

1. **Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
2. **Shqyrtimi i Raportit Financiar janar-qershor 2021;**
3. **Shqyrtimi i Propozim vendimit të Kryetarit të Komunës për shpallje Qytetar Nderi z. Qemal Minxhozi;**
4. **Shqyrtimi i Raportit të DKA-së për përfundimin e vitit mësimor 2020-2021;**
5. **Të ndryshme.**

Të nderuar anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa, me datën 19.07.2021 me ka ardhur edhe raporti i Auditorit të Jashtëm, kështu që kisha kërkuar mirëkuptimin tuaj që ta kemi si pikë shtesë edhe raportin e Auditorit të Jashtëm si dhe për mbledhje të kuvendit nëse arrijmë të jemi gati, është në pyetje shfuqizimi i vendimit i vitit 2004, që është në pjesën e Fortesës që ka qenë për ndërtimin e fabrikës e tjegullave dhe i ka kaluar koha dhe zyra ligjore është duke punuar në këtë drejtim, kështu që nëse arrijnë që brenda këtyre dy ditëve që me përgatit vendimin atëherë nëse ju pajtoheni, do ta kemi në mbledhjen e kuvendit edhe shfuqizimin e vendimit e vitit 2004 kur ka qenë ajo pjesë. Pra, të nderuar anëtarë të KPF-së, a pajtoheni që ta kemi si pikë shtesë edhe raportin e Auditorit të Jashtëm për vitin 2020 për këtë mbledhje, për shkak se me datën 19 të këtij muaji na ka ardhur raporti dhe po konsideroj se në bazë të komunikimit që kemi pasur me ju, e kam marr aprovimin tuaj. Kështu që e qesim në votim rendin e ditës me pikën shtesë. Konstatohet se unanimisht aprovohet rendi i ditës me pikën shtesë. Kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës:

**1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.**

Atëherë meqë nuk kemi asnjë të lajmëruar sa i përket procesverbalit, e qesim në votim. Konstatohet se unanimisht aprovohet pika e parë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës:

**2. Shqyrtimi i Raportit Financiar janar – qershor 2021.**

**Afrim Limani** – Përshëndetje i nderuari kryesues, të nderuar anëtarë të KPF-së dhe gjithë ju të pranishëm. Drejtoria për Buxhet dhe Financa ka arritur të përgatis raportin 6-mujor financiar edhe pse nga koha kemi qenë shumë të kufizuar sepse gjithmonë barazimet me ministrinë e financave bëhen pas datës 10 mirëpo për një kohe rekorde kemi arritur që ta përgatisim këtë dokument, që realisht që ka mundësi me pas ndonjë

gabim teknik dokumenti për shkak të shpejtësisë së përgatitjes mirëpo për mbledhje të kuvendit sigurisht se do t'i eliminojmë ato gabime. Pra, raporti 6-mujor financiar është një raport që është i kompletuar me të gjitha të dhënat dhe i cili përbëhet nga 3 pjesë, pjesa e të hyrave, pjesa e realizimit të buxhetit si dhe aktivitete të prokurimit për të gjitha ngjarjet që janë zhvilluar në prokurim për dallim nga raporti 3 mujor që nuk e kemi pasur këto shënime sepse ka qenë fillimi i vitit edhe nuk ka pasur ndonjë raport për ndonjë aktivitet. Të hyrat brenda këtij 6 mujori janë 548,000 euro dhe kur e bëjmë një krahasim me vitin e kaluar për periudhën e njëjtë ka një ndryshim pozitiv prej 143,935 euro dhe ky ndryshim pozitiv është kryesisht për shkak se vitin e kaluar kemi qenë në periudhën e pandemisë dhe nuk kemi pasur inkasim. Kurse tash realisht kur e bëjmë një analizë atëherë të hyrat janë përafërsisht të njëjta me vitin e kaluar edhe besoj që trendi i të hyrave ka me shkue deri në fund të vitit njëjtë sikur vitin e kaluar ndoshta me një diferencë pozitive me të vogël. Realizimi i buxhetit deri në këtë periudhë është në mënyrë të kënaqshme, pasi kemi arrit që buxheti të shpenzohet mbi 50% e sidomos kemi një rritje të mirë edhe në kuadër të investimeve kapitale, kështu që në fund të raportit i kemi edhe shpenzimet komunalë edhe aktivitetet që janë zhvilluar në prokurim.

**Krzesuesi** – Faleminderit shumë drejtor për sjelljen e raportit 6-mujor të financave, kështu që ne e kemi pasur materialin edhe e kemi analizuar me vëmendje përveç atyre që e ceket edhe ju se munden me qenë disa gabime teknike që sigurisht që për kuvend duhet të përmirësohen.

**Fehmi Cena** – Faleminderit kryesues, përsëritet për të gjithë. Fillimisht e falënderojmë drejtorin për Financa për përgatitjen e këtij raporti për 6-mujorin e parë janar-qershor 2021, ashtu siç e tha edhe drejtori se është raport gjithëpërfshirës me ato 3 pjesë që i ceku, pra të hyrat vetanake shpenzimet aktivitetet e prokurimit. Tek të hyrat vetanake janë shifrat që ne i shohim ashtu siç e tha edhe drejtori në raport me vitin e kaluar në tabelën 1.1 ka rritje të hyrave, gjithashtu edhe në raport me planifikimin për këtë vit ka rritje dhe sigurisht se mirë është që ka rritje pasi siç e dimë ajo rritje është siç e tha edhe drejtori për shkak se vitin e kaluar ka pasur të hyra më pak për shkak të pandemisë e sidomos është e dukshme muaji prill dhe maj edhe karantinimi. Pastaj të këto tabelat të hyrat nga gjobat e gjykatave dhe gjobat në trafik mungojnë këto 3 muaj por kryesuesi tha që për mbledhjen e kuvendit nëse i keni ato shifra do të ishte mirë me i prezantuar që të kemi me saktë, por unë duhet me ndërhyje sidomos tek gjobat në trafik pasi keni aty plot gabime teknike me këto shifra p.sh. tek shtylla e katërt duhet ta shikoni aty pasi në shtyllën e dytë i keni gjobat e trafikut 2020 totali 73,236 euro. Në shtyllën e dytë gjobat nga trafiku 2021 janë 69,934 euro pa 3 muajt e fundit mirëpo në shtyllën e katërt ndryshimin e keni 18,228 dhe kjo nuk përkon me këto shifra. Kështu që kjo është në raport me raportin 3 mujor dhe i keni shifrat e raportit 3 mujor dhe dallimi është aty që do të thotë se të shtylla e katërt nuk është 18,228 euro dallimi. Pastaj faqe 4 rreth gjobave në trafik në baza mujore 18,228 ndryshimi në raport me vitin paraprak, kështu që nuk është kjo shifër pasi kjo i takon raportit 3 mujor janar-mars, kështu që këto shifra duhet me i ndryshua për mbledhjen e kuvendit. Gjithashtu me poshtë i keni të hyrat e rregullta duke i përfshirë të gjitha këto të hyra bashkë me gjobat dhe ka një rritje prej 146,840 euro, pasi e dimë edhe planifikimi si është bërë pasi kemi pasur edhe vërejtjet e tona dhe kemi thënë që planifikimi ka qenë pak i ulët mirëpo ju si drejtori e Financave jeni arsytuar se ato limitet janë të caktuara nga niveli qendror. Pastaj në faqe 5, tabela 1.6 të krahasimi i të hyrave të realizuara sipas kodeve ekonomike 2021-2020 edhe aty disa prej këtyre kodeve ekonomike edhe në raportin 3 mujor kemi pasur disa vërejtje rreth planifikimit edhe të hyrave pasi ka një diskrepancë shumë e madhe p.sh. tek kodi 50013 taksat për certifikatat e lindjes ku planifikimi ka qenë 14,500 euro kurse të hyrat janë vetëm 711 apo kodi 50026 për taksat për legalizimin e objekteve pasi planifikimi është shumë më i madh se sa të hyrat pasi të hyrat janë shumë të vogla. Pastaj kodi 50103 largimi dhe deponimi i automjeteve, ku planifikimi ka qenë 2000 kështu që asnjë euro nuk është planifikuar dhe këtu e kisha bërë një pyetje se a arkëton komuna diçka prej kësaj veprimtarie, pasi unë mendoj se do të duhej me pas pak nga të hyrat buxhetore sepse e dimë që kemi raste kur këto automjete merren nga parkimet që janë jo në rregull që i shohim gjithandej, pastaj kodi 50405 shfrytëzimi i pronës publike edhe këtu të hyrat janë shumë pak dhe dua të di pse është kjo. Po ashtu nëse shikohet në fund të kësaj table, realizimi për 6-mujorin e parë në raport me planifikimin vjetor tek përqindja, këtu i keni 41.7% kurse nga që e kam nxjerr unë është 51%, pra më shumë keni arkëtua të hyra se sa gjysma tek përqindja, pra e njëjta tabelë pasi planifikimi ka qenë 1,061,000 euro kurse të hyrat janë 625,000 dhe kjo i bën 59%. Pastaj tek tatimi në pronë gjithashtu ka rritje, por mua më intereson pasi e keni

cekur se për këtë vit e dimë se në tatim përpos objektit është edhe oborri, por e keni cekur pasi e pash në procesverbal për malin, a do te thotë që ka tatim edhe për male, do të doja edhe një përgjigje rreth kësaj. Tek shpenzimet dua te bëj një ndërhyrje për pagat dhe mëditjet, shpenzimet i keni për këtë 6-mujore i keni 50.95% d.m.th. i keni tejkaluar shpenzimin në shumën prej 72,690 euro kështu që nëse shkohet me këtë trend deri në fund të vitit atëherë do dyfishohen shpenzimet për paga dhe mëditje, kështu që pyetja është se ku do t'i merrni këto të holla që t'i paguani pagat nëse shpenzoni më shumë se sa që keni planifikuar.

**Afrim Limani** – Faleminderit për pyetjet, qysh në fillim e thash se mund të ndodh që kemi bërë ndonjë gabim teknik për shkak të shpejtësisë së përgatitjes së raportit dhe në momentin kur jemi barazua me ministrinë e Financave ndoshta asnjë ditë nuk kemi pasur në dispozicion, që të kemi mundësinë ta shfrytëzojmë kohën për me dërgua raportin për mbledhje të KPF-së. Siç e potencova se gabimet në vlera nuk kemi gabuar mirëpo e vërejtja te një rast te përqindja e inkasimit është totalisht gabim. Pastaj, pyetja tjetër ishte te inkasimi i gjobave të gjykatave dhe gjobat nga trafiku. Unë në fillim harrova me than që deri me datën e sodit ende nuk e kemi inkasimin e të hyrave nga gjobat e gjykatave dhe trafikut, kështu që shpresoj që deri me datën 15 duhet me ardh një raport i tillë me inkasim të mirë te hyrave mirëpo deri me sot nuk ka ardhur ende asgjë. Në shtyllën e parë faqe 4 që e potencova ti e kemi përshkruar të gjitha gjobat e trafikut për vitin 2020 sipas muajve pra deri në muajin qershor që janë 73,236 euro. Në shtyllën e dytë vitin 2022 i kemi prezentuar vetëm për 3 muaj deri sa na mungon një raport nga gjobat e gjykatave edhe shuma është 18,223. Tek te hyrat edhe ne mbledhjen e kaluar ka pasur pyetje nga ana e kuvendarëve, te planifikimi te kodi 50013 për certifikatat e lindjes që janë te planifikuara 14,500 por inkasimi apo realizimi është 711, kështu që kam dhënë sqarimin edhe ne atë mbledhje dhe tash po e përsëris për shkak te softverit pra programin që e kemi pasi te gjitha te hyrat nga certifikatat e lindjes po realizohen në kodin 50016, taksa për certifikata tjera te ofiqarisë këtu kemi shumën 22,000 euro që e kemi tejkaluar planifikimin, siç e kam thënë edhe në fillim se nuk është planifikim real por për shkak te limiteve jemi detyruar me shku edhe me dal jashtë planifikimit real edhe po duhet që ne ekstrem me i zvogëluar te gjitha te hyrat. Këtu e kemi edhe shefin e IT-së që kemi tentuar disa here me bo këtë ndryshim mirëpo ka qene e pamundur. Po ashtu u bë një pyetje te kodi 50103 largimi dhe deponimi i automjeteve, që realisht ne e kemi një kontratë me një kompani e cila bën bartjen edhe ne e bëjmë pagesën por sigurisht se për kuvend do te marrim informata për këtë, sigurisht se brenda këtij viti nuk është realizuar dhe nuk ka bërë ndonjë aktivitet kështu që unë kështu po e lë sepse ne sistem çdo gjë regjistrohet. Te shfrytëzimi i pronës publike kemi planifikuar 13,447 kurse te realizuara janë vetëm 6400 euro dhe ne i kemi disa prona publike që ju kemi dhënë personave fizik ne shfrytëzim sigurisht me vendimin e juaj mirëpo deri në këtë periudhë nuk inkasim e sigurisht e kanë paguar taksen vjetore siç e kanë mirëpo brenda këtij viti besoj që do ta paguajnë. Pra planifikimi është real këtu sepse jemi bazuar në kontratat që i kemi lidhur. Te pagat, te planifikuara janë 7,622,634 euro dhe kur e përpjesëtojmë për 12 muaj atëherë mesatarja i bien për 635,219 euro paga për organizatën buxhetore që harxhohen për një vit. Kështu që kur e shumëzojmë këtë shume për 6 muaj atëherë i bien realisht mbi 3 milion, që do te thotë sipas këtij trendi shpenzimi është duke shkuar normal edhe aty këtu kemi ndonjë tepriçë në ndonjë drejtori dhe diku do te kemi edhe mangu. Po ashtu me kujtohet që me keni bërë edhe një pyetje në raportin 3 mujor, fillimisht pagat për arsim 100 euro e kanë marr prej organizatës tonë gjithashtu edhe pagën në shëndetësi mirëpo në ndërkohë i kanë kthye ato mjete edhe tash jemi në rregull me planifikim te shpenzimit te buxhetit në kuadër te kësaj kategorie edhe nuk besoj që në fund te vitit do te kemi ndonjë tepriçë.

**Kryesuesi** – Faleminderit drejtor për te gjitha sqarimet, të nderuar kolegë anëtare te KPF-së, konsideroj se kalon për kuvend edhe pika e dytë e rendit te ditës. Kalojmë në pikën e tretë te rendit te ditës:

### **3. Shqyrtimi i Propozim vendimit të Kryetarit të Komunës për shpallje Qytetar Nderi „ z. Qemal Minxhozi,,.**

**Saranda Sallteku** – Faleminderit kryesues, përshëndetje për te gjithë. Më propozim te kryetarit te komunës ju kemi sjellë propozimin për shpalljen qytetar nderi të ambasadorit të Shqipërisë në Kosovë z. Qemal Minxhozi. Ambasadori Minxhozi prej se ka marr detyrën në Kosovë ka dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm i cili po vazhdon ende të jap kontributin e madh për qytetarët tonë. Të nderuar anëtarë të KPF-së, para vetes e keni materialin për jetën dhe veprën e ambasadorit Minxhozi, ku pas shqyrtimit ju ftoj ta aprovon propozimin e kryetarit.

**Kryesuesi** – Faleminderit drejtoreshë për prezantimin, të nderuar anëtare te KPF-së, a ka dikush diçka rreth kësaj pike. Unë pajtohem që ambasadorit tonë i cili po jep ende kontributin duke pasur parasysh edhe në komunën tonë i cili ka dhënë një kontribut edhe te gratë e kooperativës Krusha po ashtu po ndihmon edhe në aspektin e shëndetësisë. Atëherë meqë nuk kemi të lajmëruar, konstatoj se kalon për kuvend edhe pika e tretë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e katërt të rendit të ditës:

#### **4. Shqyrtimi i Raportit të DKA-së për përfundimin e vitit mësimor 2020-2021.**

**Avni Morina** – Faleminderit kryesues, përshëndetje për ju anëtarë te KPF-së. Unë kam shkruar një raport të cilin ju kemi dorëzuar edhe juve për përfundimin e vitit mësimor, duke marr parasysh se viti shkollor përfundon me 31 gusht. Në këtë raport kemi shqyrtuar ecurinë e vitit mësimor prej fillimit, ku e kemi në fillim se kemi pasur dy javë vonesë për shkak të rrethanave të krijuara nga pandemia me vendim të ministrisë, pastaj e kemi përmendur të gjitha aktivitetet që i kemi pasur gjatë vitit shkollor, pastaj kemi statistikën e testit të maturës që i kemi përmendur edhe llojet e garave që i kemi mbajtur pastaj investimet që kanë vazhduar në ndërtimin e shkollave, çerdheve pastaj aktivitete të ndryshme për projekte të ndryshme që i kemi pasur për efikasitetin e energjisë, statistikën për maturanet se sa maturan kanë kaluar provimin shtetëror të maturës, pastaj testin e arritshmërisë për klasat e nënta, që të gjitha të dhënat janë të prezantuara me numra dhe përqindje, kështu që mendoj se ky raport do të ishte mirë të lexohet më gjërësisht në mbledhje të kuvendit. Nëse keni ndonjë pyetje rreth raportit, do të mundohem të jap përgjigjet e mia rreth raportit pasi jam munduar t'i përmbledh të gjitha aktivitetet e këtij viti mësimor.

**Kryesuesi** – Faleminderit i nderuar drejtor për sjelljen e këtij raporti, mendoj që është paraqitur gjendja reale e arsimit në komunën tonë.

**Fahrie Lushi** – Faleminderit kryesues, te nderuar kolegë te KPF-së dhe gjithë te pranishmit në sallë. Se pari e falënderoj drejtorin për sjelljen e kësaj informate apo raporti mirëpo ky raport i përket një periudhe të jashtëzakonshme të mbajtjes së mësimin në komunën tonë, kështu që unë pajtohem me ato që i ka përmend drejtori mirëpo për mendimin tim thjesht është e paqartë ajo p.sh. drejtori ka përmend renovimin apo ndërtimin me saktësisht të katër objekteve shkollore, që unë mendoj se ndoshta kish me qenë e arsyeshme edhe me vend me i përmend ato shkolla pasi që janë të ndërtuara nga buxheti i komunës tonë dhe sigurisht se kjo informatë do të ishte më e kompletuar nëse përmenden edhe emrat e shkollave dhe në cilat vende janë ndërtuar ato katër shkolla, e pastaj ku thotë se janë në prag të finalizimit atëherë pse mos me i përmend edhe emrat dhe vendbanimet përkatësisht se ku janë këto shkolla. Pastaj, tek testi i arritshmërisë nuk është se kemi një përqindje jo të mirë edhe pse mbajtja e mësimin ka qenë në rrethana jo të zakonshme, pastaj edhe testi i maturës është njëjtë sepse ne duhet megjithatë të bazohemi në rrethanat në të cilat u realizua mësimi këtë vit.

**Kryesuesi** – Faleminderit zonja Lushi, atëherë meqë nuk kemi tjerë të lajmëruar, konsideroj se kalon për kuvend edhe pika e katërt e rendit të ditës.

Të nderuar të pranishëm ashtu siç u dakordua që të kemi edhe pikën shtesë të raportit të Auditorit të Jashtëm, siç ju thash edhe më herët materialin në momentin e parë që ka mbërri në Zyrën e Kuvendit ju kemi dërguar mirëpo realisht nuk kemi mundur me shfletuar komplet për mbledhjen e sodit. Mirëpo është shumë me rëndësi në material aty prej raportit të Auditorit të Jashtëm e pash që komuna jonë është se ka opinionin e pamodifikuar për vitin 2020, kështu që ju falënderoj për mirëkuptimin tuaj.

**Afrim Limani** – Unë mendoj se draft raporti na ka ardh para dhjetë dite edhe menjëherë e kam analizuar mirë në detaje, mirëpo raporti final na ka ardh pikërisht në datën që ju është dërguar edhe juve, pasi kemi deshtë ashtu ta keni si material edhe ndoshta dikush ka mundësi me shfletue mirëpo edhe ne të jemi gjithçka në rregull në raport me juve. Raporti i Auditorit të Jashtëm i pasqyrave financiare i komunës së Rahovecit për vitin 2020 konsideroj se është njëri prej raporteve më të mira deri më tani sepse për herë të parë e ka marr një opinion që në gjuhën e tyre quhet opinion i pamodifikuar për pasqyrat financiare vjetore, pasi që sikur të kish qenë me theksim të çështjes nuk do të kishte shkruar këtui, kështu që është raport i pamodifikuar, që kualifikohet si raport pozitiv. Pastaj nga numri i rekomandimeve që i kemi pasur vitin e kaluar në raport me këtë raport ka zbritur nga 14 në 12 edhe zbatimi i rekomandimeve të vitit të kaluar që për mendimin tim ndoshta aty nuk jam i kënaqur, pasi janë 4 rekomandime të zbatuara por janë edhe disa në proces por nuk e ka potencuar në raport pra nuk shkruan se janë në proces. Pra, lirisht mund të ju them se është njëri prej

raportëve me të mira dhe pjesë e kontributit jemi të gjithë jo vetëm ne ekzekutivi por edhe ju si kuvend duke dhënë kontributin tuaj duke na dhënë kritika vërejtje që me u permisue ne. Faleminderit shumë.

**Kryesuesi** – Faleminderit drejtor për sqarimin, vërtet pajtohem me ju që thatë se pjesë e kontributit rreth raportit është edhe kuvendi, kështu që është mirë që kemi një raport të pamodifikuar.

Te nderuar kolegë, konsideroj se edhe kjo pikë kalon për kuvend. Kalojmë në pikën e radhës:

#### **5. Të ndryshme.**

Atëherë meqë nuk kemi të lajmëruar sa i përket kësaj pike, unë ju falënderoj të gjithëve për kontributin e dhënë dhe shihemi ne mbledhjen e radhës.

**Mbledhja përfundoj 10:40**

Procesmbajtësi,

Agim Hoti

